



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
*Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia*  
*Izhorni Panel za Žalbe i Predstavke*

**A nr. 299/2010**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga, Rafet Haxhaj kryesues, Nehat Idrizi dhe Vllastimir Dimiç, anëtarë, duke vendosur përkitazi për ankesën e Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës(LDK) me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) për shkak të publikimit të materialit zgjedhor para fillimit të fushatës zgjedhore për zgjedhjet e 12 Dhjetorit , në seancën e panelit të mbajtur me 02.12.2010, mori këtë:

#### **VENDIM**

**HIDHET** poshtë ankesa si e parregullt.

#### **ARSYETIMI**

Subjekti politik (LDK), me seli në Prishtinë, ka parashtruar ankesë me të cilën pretendon se (PDK), ka bërë shkelje të nenit 44.1 të Ligjit mbi Zgjedhjet e Përgjithshme duke bërë publikimin e materialit zgjedhor para fillimit të fushatës zgjedhore..

#### **FAKTET**

Më 30. Nëntor 2010, Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP) ka pranuar një ankesë që është dorëzuar nga Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), duke pretenduar se Partia Demokratike e Kosovës (PDK), ka bërë shkelje të ligjit pasi që ende pa filluar periudha e fushatës zgjedhore ka publikuar material zgjedhor me numrin e saj 49 që do ta ketë në fletëvotim..Këtë e ka bërë në tubimet e mbajtura në Gjakovë me 27.11.2010 (duke iu referuar lajmeve qendrore të KTV-së të datës 27.11.2010 të orës 19:00) dhe në Mitrovicë me 28.11.2010 (duke iu referuar lajmeve qendrore të mbrëmjes të datës 28.11.2010 në ora 18:43 minuta).

Parashtruesi i ankesës nuk i ka bashkangjitur ankesës asnjë provë.

## ANALIZË

Juridiksioni i PZAP-it lidhur me ankesat është caktuar në pajtim me kompetencat e dhëna nga Kuvendi i Republikës së Kosovës në *Ligjin mbi Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës – LZP*, Ligji Nr.03/L – 256 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L- 073 dhe *Ligjin për Zgjedhjet Lokale në Republikën Kosovës* Ligji Nr. 03/L- 072.

Parashtruesi i ankesës pretendon se (PDK), ka shkelur nenin 44.1 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme duke bërë publikimin e materialit zgjedhor para fillimit të fushatës së zgjedhjeve, prej 01 dhjetor 2010.

Neni 118 paragrafi 1 i LZP-së, specifikon:

*118.1 PZAP-i pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk përmbushin standardet.*

Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, neni 3.6, pika (c) parashohin si vijon:

*3.6 (c) Hollësi rreth çfarëdo dëshmie dhe kopje të çfarëdo dokumentacioni relevant apo dëshmi tjera në posedim të ankuesit ose udhëzime se ku mund të gjenden dëshmitë, në rastet kur të njëjtat nuk janë në posedim të ankuesit*

PZAP-i konstaton se ankesa është e parregullt për faktin se nuk i përmban elementet e detyrueshme të parashikuara në nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së dhe elementet e parashikuara në nenin 3.6 pika c) të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, ngase parashtruesi i ankesës nuk i ka bashkangjitur ankesës asnjë dëshmi.

Për këto arsye, bazuar në dispozitën e nenit 115.1 të LZP, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

### Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia në Prishtinë

A nr. 299/2010 më datën 02.12.2010

Kryesuesi i Panelit



Rafet Haxha